



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

Nr. 7300 Prot.

Korçë, më datë 10.07.2026

SHPALLJE

Për dhënien me qira:

1. Të pasurisë tokë "arë" me sipërfaqe 64 900 m² me numër pasurie 438, zonë kadastrale nr.1491, të ndodhur në fshatin Dishnicë, Njësia Administrative Bulgarec, Bashkia Korçë.
2. Të pasurisë tokë arë me sipërfaqe 50 100 m² me numër pasurie 446/2 zonë kadastrale nr.1491, të ndodhur në fshatin Dishnicë, Njësia Administrative Bulgarec, Bashkia Korçë.

Çdo subjekt, person fizik dhe/ose juridik, vendas apo i huaj i cili kërkon të marrë me qira tokat arë të sipërpërmendura duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar kryetarit të bashkisë ku të përfshihen:

1. Të dhënat e kërkesës;
2. Afati i qirasë;
3. Veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose specie e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;
4. Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;
5. Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj;
6. Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare;
7. Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
8. Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).
9. Plan i hollësishëm biznesi.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet pranë **Zyrës së Protokoll-Arkivës, Bashkia Korçë brenda 10 ditëve** nga data e shpalljes.

Data e zhvillimit të konkursit 27.07. 2026 ora 11:00

Vendi i zhvillimit të konkursit: Bashkia Korçë, salla e mbledhjeve, kati i dytë.

Kriteret e vlerësimit dhe sistemi i pikëzimit:

1. Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe në përpunimin e produkteve (25 pikë)
2. Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj (25 pikë)
3. Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në Bashkinë e Korçës (25 pikë)
4. Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit). (25 pikë)
 - (Çmimi minimal i ofruar nuk mund të jetë më pak se 6000 lekë/ha në vit)

U shpall në datë 10.07.2026

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo

